

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E RAHOVECIT OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
---	---	---

Për:	Grup i Operatorëve Ekonomik: Infra-Plus SH.P.K.; SELMANS NETWORKS SH.P.K., Rr. Luan Haradinaj Sol.1 H.1, 10000, Prishtinë Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	19.09.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A, paragrafi 10.1 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 63 paragrafi 1 të Rregullores **Nr. 001/2022** për Prokurim Publik, sa i përket **Kërkesës për Rishqyrtim** të datës: **18.09.2023**, të parashtruar nga **Grup i Operatorëve Ekonomik: Infra-Plus SH.P.K.; SELMANS NETWORKS SH.P.K.** me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **NDËRTIMI DHE RREGULLIMI I INFRASTRUKTURËS NË STACIONIN E AUTOBUSËVE – Ritenderim**, me Numër të prokurimit: **623-23-7702-5-2-1**, Numër i brendshëm: **623-23-037-5-2-1**, nxjerr:

VENDIM

- I. **HEDHET POSHTË** si e pa bazuar Kërkesa për rishqyrtim e parashtruar nga **Grup i Operatorëve Ekonomik: Infra-Plus SH.P.K.; SELMANS NETWORKS SH.P.K.** me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **NDËRTIMI DHE RREGULLIMI I INFRASTRUKTURËS NË STACIONIN E AUTOBUSËVE – Ritenderim**, me Numër të prokurimit: **623-23-7702-5-2-1**, Numër i brendshëm: **623-23-037-5-2-1**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK-së, të datës: **13.09.2023**, të publikuar në ueb – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- II. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me me hapat e mëtejshëm për këtë aktivitetin të prokurimit
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

ARSYETIM

Grup i Operatorëve Ekonomik: Infra-Plus SH.P.K.; SELMANS NETWORKS SH.P.K. me adresë në **Prishtinë**, me datë: **18.09.2023** si palë e pakënaqur ka deponuar Kërkesë për Rishqyrtim pran AK Komuna e Rahovecit, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **NDËRTIMI DHE RREGULLIMI I INFRASTRUKTURËS NË STACIONIN E AUTOBUSËVE – Ritenderim**, me Numër të prokurimit: **623-23-7702-5-2-1**, Numër i brendshëm: **623-23-037-5-2-1**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ - Komuna e Rahovecit, kundër Njoftimit mbi Vendim të AK-së të publikuar me **13.09.2023** në linkun <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

BAZA LIGJORE PËR REFUZIM TË KËRKESËS

Përgjigjja e AK ndaj Pretendimeve Ankimore;

Ju sqarojmë se pretendimet e tua ankimor nuk qëndrojnë dhe janë të pabazuara, pasi që vlerësimi i ofertave është bërë konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik
Autoriteti Kontraktues: Komuna e Rahovecit, ju ka Njoftuar juve si Operator Ekonomik ankues, sipas formularit **B42 Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar**, ku nuk e keni plotësuar këto kriter sipas Njoftimit për Kontrate/Dosjes se tenderit:

Kapaciteti teknik dhe profesional:

Kërkesa 1: Numri i punëtorëve të angazhuar në këtë projekt, min. 10 punëtor me të dhënat në vijim: Emri, mbiemrin, mosha e punëtorit, profesioni, eksperiencia (vite) dhe pozicioni në kompani;

Dëshmia 1: Lista e numrit të punëtorëve të angazhohen për kryerjen e punëve, min. 10 punëtor me të dhënat në vijim: Emri, mbiemrin, mosha e punëtorit, profesioni, eksperiencia (vite) dhe pozicioni në kompani dhe nënshkrimi i punëtorëve në atë liste – duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik;

Sqarimet janë si në vijim:

Në ofertën e juaj të dorëzuar si Grup i Operatorëve Ekonomik, nuk keni dorëzuar **Listën e numrit të punëtorëve të angazhohen për kryerjen e punëve, min. 10 punëtor**, sipas Kapaciteti teknik dhe profesional, përkatësisht **Kërkesë Nr. 1** të Dosjes se Tenderit, ku dokumenti në fjale nuk mund të kërkohej në bazë të Nenit 72, paragrafi 3. ku thotë: *Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive, ku dokumenti në fjale nuk mund të vërtetohet se ka ekzistuar para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, andaj oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme konform nenit 59.4 të LPP-së*

Kërkesa 2: Operatori Ekonomik duhet te ketë ne listën te paktën këtë staf profesional:
2.3. Inxhinier i Diplomuar ne Inxhinieri Elektroteknike ose master - me përvojë pune min. 5 vite pas diplomimit;

Dëshmia 2: Diplomati përkatës – Kopje të noterizuar, (noterizimi të prezantohet nga vetë inxhinieri te noteri);

Sqarimet janë si në vijim:

Në ofertën e juaj të dorëzuar, për pozitën Inxhinier i Diplomuar ne Inxhinieri Elektroteknike ose Master, me përvojë pune min. 5 vite pas diplomimit, keni prezantuar z.

Sami Shatri;

Në Njoftim për Kontratë dhe sipas Dosjes së tenderit tek Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT), tek Kapaciteti teknik dhe profesional, nga dëshmitë e kërkuar dokumentare është kërkuar: *Diplomat përkatës – Kopje të noterizuar, (noterizimi të prezantohet nga vetë inxhinieri te noteri);*

Noterizimi i diplomës nuk është bërë nga vetë Inxhinieri para noterit, por është bërë nga z. **Arbër Islamaj**, andaj oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme konform nenit 59.4 të LPP-së

2.4. Inxhinier i Diplomuar ne Inxhinieri Makinerike ose master - me përvojë pune min. 5 vite pas diplomimit;

Dëshmia 2: Diplomati përkatës – Kopje të noterizuar, (noterizimi të prezantohet nga vetë inxhinieri te noteri);

Sqarimet janë si në vijim:

Në ofertën e juaj të dorëzuar, për pozitën Inxhinier i Diplomuar ne Inxhinieri Makinerike ose master, me përvojë pune min. 5 vite pas diplomimit, keni prezantuar z. **Xhevdet Duka;**
Në Njoftim për Kontratë dhe sipas Dosjes së tenderit tek Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT), tek Kapaciteti teknik dhe profesional, nga dëshmitë e kërkuar dokumentare është kërkuar: *Diplomat përkatës – Kopje të noterizuar, (noterizimi të prezantohet nga vetë inxhinieri te noteri);*

Noterizimi i diplomës nuk është bërë nga vetë Inxhinieri para noterit, por është bërë nga z. **Afrim Gashi**, andaj oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme konform nenit 59.4 të LPP-së

Kërkesa 5: Operatori Ekonomik duhet të posedojë mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit, pajisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës në Aneksin 8 të Dosjes së Tenderit;

Dëshmia 5: Pajisjet të cilat regjistrohen duhet të dëshmohen me librezën e regjistrimit (pajisjet duhet të jenë me afat të regjistrimit), ndërsa pajisje tjera Operatori Ekonomik duhet ti dëshmojë me një dokument për pronësinë e pajisjeve (faturë, DUD etj).

Vëmendje!

Në rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet të ofroj marrëveshjen për marrjen me qira të pajisjeve. Marrëveshja duhet të jetë në emër të këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate nënshkruar dhe vëlosur nga të dyja palët. Marrëveshja duhet të jetë e noterizuar në mes të qiradhënësit dhe qiramarrësit;

Sqarimet janë si në vijim:

Në ofertën e juaj të dorëzuar si Grup i Operatorëve Ekonomik, ANEKSIN 8 i Dosjes së Tenderit **është i panënshkruar dhe pavëlosur nga ana juaj**, ku dokumenti në fjalë nuk mund të kërkohej në bazë të Nenit 72, paragrafi 3. ku thotë: *Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive, andaj oferta juaj konsiderohet e përgjegjshme konform nenit 59.4 të LPP-së*

Nga konstatimet e lartcekur u vendos si në dispozitave të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij **vendimi të AK-së ju mundet të paraqitni** ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

Astrit Mullabazi
Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Komuna e Rahovecit